



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

MIRATOHETE
KRYETARE E BASHKISE
Alma HOXHA

PLAN – MASASH

Për

Parapërgatitjen dhe përballimin e situatave të mundshme që mund të krijohen në qytetin e Permetit para-gjate dhe mbas organizimit të Festivalit „NONA“ në datat: 11-12-13 Gusht 2023.

Baza ligjore:

Ligji nr. 139/2015, dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” Ligj rr.8378, datë 22.7.1998 „Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë“ i ndryshuar, Ligji nr. 8308, dt. 18.3.1998 “Për transportet rrugore” i ndryshuar, Ligjit nr 107/2014 datë: 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Vendimi nr 3 datë 10.06.2020 te KKT “Për Miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Permet, Vendimi nr 1096 date 28.12.2015 “Per miratimin e kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike” Vendimi i Këshillit të Bashkisë Nr.23 datë; 31/03/2022 “ Për miratimin e rregullores “Per kushtet dhe rregullat e zenies së hapësires publike ne Bashkinë Permet”,

Objektivi: Parapërgatitja dhe informimi i qytetarëve nga strukturat shtetërore, për situatën që mund të krijohet, gjatë organizimit të koncertit NONA në datat 11-12-13 Gusht 2023. Marja e masave për parandalimin, mbarvajtjen, evitimin e trafikut gjatë organizimit të këtij eventi.

Informimi dhe monitorimi i situatës.

Situata: Organizimi i festivalit NONA në qytetin e Permetit në datat 11-12-13 Gusht 2023, bazuar edhe nga eksperiencia e viteve të kaluara, sjell si nevoje marjen e masave me qellim mbarvatjen sa me te mire të ketij evenimenti. Këto masa konsistojne ne informimin e banoreve të qytetit të Permetit por edhe banoreve të tjere që mund të jene pjesë e këtij koncerti.

Prioritetet dhe masat për parandalimin e trafikut në qytet.

Bashkia Permet u bën thirrje qytetarëve të shmangin sa më shumë levizjet me mjet në qytet gjatë diteve të organizimit të koncertit. Nisur nga eksperiencia e viteve të kaluara, nga ana e strukturave shtetërore, Bashkia Permet-Komisariati i Policise Permet, Sektori i Qarkullimit Rrugor do të jenë prezent për zbatimin me rigorozitet te trafikut gjate diteve të organizimit të eventit sidomos në orët e pasdites dhe mbrëmjes.

Me qëllim lehtësimin e trafikut rrugor në Qytetin e Permetit Bashkia Permet në bashkëpunim me Komisariatin e Policise Permet, Policine Bashkiake informon qytetaret si me poshte.

- 1- Do të lejohet parkimi i automjeteve në një krah (krahu i majte) në rrugën Meleq Gosnishti (Gjykate-kryq. shkolla Meleq Gosnishti) *vetem në datat 11-12-13 Gusht 2023*
- 2- Do të lejohet parkimi i automjeteve në nje krah (krahu i majte) ne rrugen 13-Shtatori (Godina e Bashkise-Kinemaja e re) *vetem ne datat 11-12-13 Gusht 2023*
- 3- Do të lejohet parkimi i automjeteve ne nje krah (krahu i majte) në rrugën Elena Gjika (kryq. tek fotografet deri tek hyrja e rrugës se Avdiut) *vetem në datat 11-12-13 Gusht 2023.*
- 4- Do të lejohet parkimi në rrugën Baba Alushi (nga kryqëzimi karburanti ANNEL deri tek kryqëzimi me lagjen Sede) *vetem në datat 11-12-13 Gusht 2023.*
- 5- Do të lejohet parkimi në rrugën përgjate lumit Vjose (nga subjektet ne krah të urës deri tek kryqëzimi hotel Ramiz) *vetem në datat 11-12-13 Gusht 2023.*
- 6- Në të gjitha rrugët e tjera të qytetit do të respektohet sinjalistika rrugore vertikale dhe horizontale.
- 7- **Ndalohe**t parkimi i automjeteve në shëtitoren Odise Paskali, në dhe përreth sheshit qëndror **“Abdyl Frashëri”** me përjashtim të automjeteve të cilat janë infrastrukturë mbështetëse e organizimit të koncertit.

Figura 1, Pamje e pergjitheshme, rruget Qyteti Permet.





Figura 2, rruget qe do te lejohet parkimi i automjeteve



Menaxhimi dhe përdorimi i hapësirave publike.

Bashkia Permet i drejtohet subjekteve private të cilët kanë leje të vlefshme për shfrytëzimin e hapësirës publike që të tregohen të kujdesshëm për përdorimin e kësaj hapësire. Këto subjekte gjate diteve të organizimit të koncertit mund të përdorin hapësirën publike jashtë sipërfaqes së miratuar në leje, por pa penguar lëvizjen e këmbësoreve apo pjesmarrësve të tjere të koncertit. Në cdo rast ata janë të detyruar tu drejtohen strukturave përgjegjëse të Bashkisë.

Me përfundimin e koncertit, subjektet janë të detyruar të respektojnë shfrytëzimin e hapësirës publike sipas lejes së miratuar nga Bashkia.

BASHKIA PERMET